



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

**Mbledhja nr. 18/2009**  
**Më 09. 06. 2009, në orën 11:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**Procesverbal**

**Në mbledhje morën pjesë:** Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Kaqusha Jashari, Safete Hadërgjonaj, Berim Ramosaj dhe Zef Morina.

**Munguan:** Slobodan Petroviq, Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala dhe Múfera Şinik.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Dino Asanaj dhe Avni Jashari – KPA, Krenare Sfishta, Adnan Preniqi dhe Novitet Nezaj – MEM, Lejla Selimi –OSBE, Osman Sadikaj – AKK, Besim Zeqiri – ICO, Haxhi Gashi – USIAD, Ramadan Klisurica – KDI, Lumnije Berisha – ZPRK, Blerina Uka – NDI dhe Ibrahim Krasniqi – konsulent i Komisionit.

**Nga Zyra Mbështetëse:** Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

**Mbledhjen e drejtoi:** Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19. 05. 2009;
3. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP, për vitin 2008;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për gazin natyror;
5. Të ndryshme.

## **I. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## **II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 26. 05. 2009**

Procesverbali i mbledhjes së datës 26. 05. 2009 u miratua pa vërejtje.

## **III. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP për vitin 2008**

**Kryetarja** – Ia dha fjalën Dino Asanajt, kryetar i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në vijim AKP), për të paraqitur ekspozenë e tij për Raportin vjetor të APK-së, për vitin 2008.

**Dino Asanaj -Kryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së** – Theksoi se edhe pse Ligji për themelimin e Agjencisë ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2008, Agjencia në fillim ka pasur ca pengesa që ishin çështje teknike dhe puna në Agjenci ka filluar në shtator të vitit 2008. Duke shtuar se fillimi i punës ka qenë i vështirë për shkak se të gjitha zyrat dhe të gjitha të dhënat nuk kanë qenë në Agjenci, por kanë qenë në deponi të UNMIK-ut, prej nga me angazhimin e miqve ndërkombëtarë është arritur të kthehet dokumentacioni në versionin elektronik, si dhe në atë të shkruar. Shtoi se gjatë vitit 2008 janë aprovuar të gjitha politikat e AKP-së, si ato financiare dhe organizimi i Agjencisë, si dhe janë realizuar 3 (tri) valë të privatizimit 31, 32 dhe 33. Po ashtu, tha se është aprovuar biznesplani gjatë vitit 2008, është aprovuar ndryshimi me statusin e Agjencisë, është rritur numri i ankesave të shqyrtuara të punëtorëve 20%, ku më parë AKM-ja ka pasur vetëm 2 (dy) të punësuar, ndërkaq tani janë 12 (dymbdhejtë), që do të merren vetëm me 20%. Gjithashtu tha se në dhjetor ka filluar shqyrtimi dhe diskutimi mbi gjendjen e ndërmarrjeve shoqërore, të cilat janë privatizuar me Spinoff Special, duke sqaruar se Agjencia e Privatizimit ka përdorur tri metoda: Spinoffi i Rregullt, Spinoffi Special dhe Likuidimi. Në janar të vitit 2009 janë formuar 120 komunitete të likuidimit, por ende nuk ka anëtarë ndërkombëtarë. Sipas Planit të Ahtisaarit, me anëtarët e Komunitetit të Likuidimit duhet të jetë një ndërkombëtar.

**Kryetarja** - Ua dha fjalën deputetëve për t'i shtruar vërejtjet, pyetjet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me Raportin.

**Safete Hadërgjonaj** - E vlerësoi lartë përpilimin e Raportit, po ashtu edhe debatin për procesin e privatizimit e cilësoi si mjaft të rëndësishëm. Sot po debatojme një document të përgatitur mirë, ku është paraqitur puna e AKP gjatë gjysmës së vitit të kaluar. Me këtë proces të privatizimit ka qenë një proces i mbyllur për qytetarët, njëkohësisht ka qenë proces i mbyllur edhe për Kuvendin. Asnjëherë nuk ka pasur asnjë Raport nga AKM-ja e mëparshme, kështu që për çdo gjë që ka pasur të bëjë me privatizimin ka qenë jotransparente, në të cilën jepet mundësia të dyshohet se aty ka keqpërdorime. Me formimin e Agjencisë Kosovare për Privatizim ka filluar hapja ndaj qytetarëve. Me hapjen ndaj Kuvendit konsideroj se është bërë një punë shumë e mirë. Pastaj tha se ky

proces ka pasur ngecje, por ka pasur edhe përparësi të caktuara, sepse ka luajtur një rol të konsiderueshëm në rritjen e eksporteve. Vlera e eksporteve të ndërmarrjeve të privatizuara ka qenë pothuajse dyfishi i vlerës së eksporteve të pjesës tjetër të sektorit privat, çka do të thotë se është një proces shumë i rëndësishëm, i cili reflektohet në ekonominë e vendit. Duke u ndaluar në hollësitë e Raportit, tha nëse merret edhe analizohet Raporti AKP-së, mund të vijmë në përfundim se në këtë periudhë, që nga koha e fillimit të punës e deri më tani janë bërë punë të shumta, të cilat janë për t'u admiruar dhe për t'u theksuar, sepse vetë fakti që me marrjen e kompetencave nga ky Bord asnjë dokumentacion nuk ka qenë aty, atëherë aty hapen dilema për dyshimin e tërë procesit të privatizimit që ka ndodhur në të kaluarën. Ndonëse ka filluar nga zeroja, prapëseprapë janë bërë disa punë, të cilat janë për t'u theksuar, si çështja e 20% - shit, që duhet t'u takojë punëtorëve. 1000 punëtorëve ju ka shpërndarë kjo shume apo në vlerë mbi 2.5 milion euro. Janë shqyrtuar me mijëra ankesa në listat e shumta të punëtorëve dhe është bërë publikimi i tyre. Nga raporti vërejmë se është rritur numri i punëtorëve në atë pjesë ku ka të bëjë me shqyrtimin e ankesave nga 2 në 12 siç u tha nga kryetari . Ndoshta për ne është me rëndësi me ditë cilat janë objektivat për të ardhmen, edhe pse shohim se në 2008 është punuar në drejtim të kompensimit të 20%, pasi ky është një shqetësim për punëtorët dhe për këtë çështje është debatuar shumë në Kuvendin, është debatuar shumë nga qytetarët dhe nga institucionet e ndryshme Sa i përket Raportit financiar, ajo tha se është ofruar një raport i pasqyrave financiare, që ne nuk jemi mësuar të marrim raporte të tilla nga agjencitë, d.m.th. është një raport shumë i hollësishëm dhe gjithëpërfshirës, duke mos e shtjelluar, sepse do të jetë objekt diskutimi edhe në Komision për Buxhet.

**Ethem Çeku** – Ishte i pajtimit me deputetën Hadërgjonaj, që të mos diskutohej për aspektin financiar, por për politikën që i zbaton ose do t'i zbatojë në të ardhmen AKP-ja, duke potencuar faktin se gjërat duhet të ndryshohen së paku të resurset vitale, që të ndryshohen ato politika. Ai shprehu keqardhje se ky proces është tepër i ngadalshëm në aspektin e politikave sa i përket Qeverisë, e cila do të duhej ta ndihmonte Agjencinë për të pasur një bazë të mirë të veprimit, gjithnjë në sektorin përkatës të energjisë dhe të minierave, sepse do përballet Agjencia me problemin më të madh, siç është çështja e Trepçës, edhe pse janë bërë disa hapa në të kaluarën për stabilizimin e kompleksit industrial të Trepçës dhe reflektimet e tij në zhvillimet ekonomik. Shprehu keqardhje që edhe pas dy vjetve nuk ka ndonjë lëvizje në këtë drejtim. Po ashtu tha se duhet të mbrohen politikat sa u përket çështjes së menaxhimit dhe formës së kyçjes së investitorëve në resurset energjetike dhe në resurset minerale dhe kjo vjen edhe për shkak të mungesës së strategjisë që duhet të vijë nga ministria. Kjo do të thotë gjërat po ndërliken njëra pas tjetrës. Pyeti se a mund të ndërtohen politika të tjera bashkë me Kuvendin, Komisionin, Qeverinë dhe me institucionet e tjera, sa i përket çështjes së kompleksit industrial, posaçërisht të Trepçës? Ndërkaq sa i përket formave të privatizimit, tha se spinoffi special duhet të rivlerësohet, duhet të rivlerësohen efektet pozitive dhe negative, pastaj tha se po ashtu duhet të bëhet një vlerësim çka solli privatizimi në Kosovë dhe cilat kanë qenë efektet që të ecet përpara.

**Kaqusha Jashari** – Ishte e brengosur rreth segmentit të sigurimit që ka qenë në AKM më parë dhe pyeti si është e mundur të mos bëhet pranim-dorëzimi i publikimeve dhe si ndodhi që UNMIK-u nuk ka siguruar të dhëna?

**Kryetarja** – Kërkoj që të mirren hapat e amendamentimit të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ose plotësimin dhe ndryshimin e nenit për drejtorinë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sepse atëherë nuk mund të thuhet se e kanë bërë ristrukturimin e mirë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe *e dyta* numri i ankesave të mëparshme të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, së paku t’i jepet një raport në mënyrën më të sinqertë dhe të shihet qartë se çka po ndodh me ndërmarrjet shoqërore të privatizuara. Pyeti: sa po plotësohet numri i ankesave të punëtorëve që ende nuk e kanë marrë 20%-in, ndërsa në 20% - sh futen njerëzit që kanë punuar pas luftës? Politikat zhvillimore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë të varura prej politikave të zhvillimit strategjik nacional të Qeverisë së Kosovës; si do të shkojë çështja e ndërmarrjeve shoqërore me Spinoff Special, me ato të cilat i kanë plotësuar kontratat gjatë shitblerjes? Si do të shkojë puna e likuidimit, që do të jetë një çështje shumë e ndieshme, duke marrë parasysh se sa është fondi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore? Çka do të ndodhë me investimet e reja, kur ende shumë pak kemi investime në ndërmarrjet shoqërore dhe çfarë ofertues do të kemi për këto privatizime?

**Berim Ramosaj** – Kishte dilema rreth pikës së rendit të ditës dhe shtjellimit të saj. Pyeti se a duhet të shqyrtohet Raporti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit i vitit 2008, apo është fjala për Raportin vjetor financiar të kësaj Agjencie në periudhën 2008? Meqenëse në mbledhjen e fundit të asamblesë për privatizimin në mënyrë unanime, gati krejt Kuvendi, ka dalë me një konkluzion se vertet privatizimi nuk i ka dhënë ata objektiva që i ka paraparë në fillim. Shtoi se nuk kishte asgjë t’i shtonte asaj konkluzë që e ka nxjerrë Kuvendi para dy javësh. Kështu që ishte i pajtimit të flitet vetëm për Raportin Financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, kurse për Raportin e procesit, qoftë të privatizimit, të mënyres së privatizimit, të nivelit të likuidimit, që po bëhet te ndërmarrjet shoqërore, të diskutohet një ditë tjetër, respektivisht me një raport tjetër.

**Ethem Çeku** – Sqaroi se për shqyrtimin e Raportit Financiar është Komisioni për Buxhet dhe Financa, duke shtuar se si Komisioni në aspektin profesional duhet ta trajtojë problemin dhe ta zgjidhë dilemën se cilat janë politikat e Agjencisë së Re, e menaxhuar nga kosovarët për resurset zhvillimore të Kosovës.

**Berim Ramosaj** – Ishte i pajtimit të mos zhvillohet debat i thatë. Po që se do të bisedohet për politikat dhe për vizionin e AKP-së, kërkoj material tjetër, kurse sa i përket Raportit Financiar nuk kishte vërejtje.

**Dino Asanaj - Kryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së** – Duke iu përgjigjur pyetjeve të deputeteve dhe duke i sqaruar dilemat e tyre, tha: “ Është dorëzuar Raporti në Kryesinë e Kuvendit dhe se sipas ligjit një herë në vit duhet të raportohet. Raporti vjetor do të vijë këtë vit në shtator. Sa i përket diskutimit në seancën e fundit, që është mbajtur në Kuvend, nuk ka qenë diskutim rreth privatizimit, por janë dërguar me shkrim tri pyetje për t’iu përgjigjur disa deputetëve; pyetjet ishin për Feronikelin, Llamkosin dhe për Tokat Bujqësore. Përgjigjet janë dhënë me shkrim. Shtoi se pret që Kuvendi t’ia japë mundësinë në shtator të këtij viti dhe kur të bëhet një vit të dalë me raport, me analizë të Agjencisë së kaluar dhe me vizionin për të ardhmen, si dhe t’i përfshijë të gjitha llogaridhëniet.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni nxori këtë

### **Përfundim**

- I. Komisioni e shqyrtoi dhe e miratoi Raportin financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP për vitin 2008 dhe nxori këtë

### **Rekomandim**

- I. Kryesia e Kuvendit ta procedojë në seancë plenare, për shqyrtim Raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP për vitin 2008

Komisioni, duke marrë parasysh gjendjen dhe rrjedhën e privatizimit në vend, në vazhdim miratoi edhe kërkesën e cila i drejtohet AKP-së, që Komisionit t'ia dërgojë një Raport të hollësishëm rreth politikave të privatizimit, në veçanti lidhur me resurset energjetike dhe për mineralet në Kosovë, në një afat të afërt.

## **IV. Shqyrtimi i Projektligjit për gazin natyror**

**Kryetarja** – Kërkoi të mos shtjellohej kjo pikë e rendit të ditës, sepse në mbledhje mungon raportuesja e Grupit të Punës, Sala Berisha – Shala, kështu që do të jetë si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës.

**Ethem Çeku** - Kërkoi të organizohet dëgjim publik për Projektligjin për gazin natyror, sepse do të këtë vend të dërgohen vërejtje dhe sugjerime nga ekspertë të kësaj fushe.

## **V. Të ndryshme**

### **a) Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët**

**Zef Morina** – Kërkoi që kjo çështje të mos shqyrtohet në pikën *të ndryshme*, por si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës.

### **b) Korniza afatmesme e shpenzimeve 2010 – 2012**

**Kryetarja** – Vlerësoi se nuk është e arsyeshme të diskutohet për këtë çështje. Ose të formohet Grup i Punës tanimë kur do të diskutohet në seancën e datës 11. 06. 2009.

### **c) Projektligji për standartizim**

**Kryetarja** – Kërkoi nga anëtarët e Grupit të Punës, Safete Hadërgjonaj dhe Kaqusha Jashari, ta intensifikojnë punën për këtë projektligj.

#### **d) Projektligji për rezervat shtetërore të mallrave**

**Kryetarja** – Kërkoi nga raportuesi i këtij Projektligji që ta njoftojë Komisionin për gjendjen procedurale të tij.

**Safete Hadergjonaj** –Theksoi se kjo çështje është për trajtim si pikë e veçantë e rendit të ditës, e jo të shqyrtohet në të ndryshme. Pastaj e njoftoi Komisionin se Grupi i Punës e ka shqyrtuar dhe analizuar Projektligjin bashkë me stafin Mbështetës të Komisionit dhe janë bërë disa amendamente. Mirëpo ka shqetësime të mëdha, sepse është një Projektligj më një problematikë të veçantë dhe që ka implikime buxhetore. Këto implikime buxhetore nuk janë të parapara në buxhet dhe nuk janë as të parapara në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve Buxhetore. Aty paraqiten problematika të tjera lidhur me çështjen e furnizimit me mallrat, të cilat shkojnë në rezerva, çështjen e plasimit të këtyre rezervave kur t'u vijë koha të dalin në treg, çështjen e formimit të drejtorive në nivel qendror dhe në nivel lokal. Andaj implikimet buxhetore janë të mëdha dhe amandamentimet shkojnë diku mbi 50 % të Projektligjit, ndoshta edhe më shumë, tha Hadergjonaj. Ajo shtoi se kishte vërejtur se ky projektligj është më tepër huazim i pjesëve të ligjeve të ndryshme dhe nuk janë bazuar vetëm në një ligj, të cilin e ka një shtet i caktuar, po ashtu tha se ka edhe sugjerime nga instancat e tjera se duhet t'i kthehet Qeverisë në ripunim.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë:

#### **Rekomandim**

- I. Që Kryesia t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim përfundim të Komisionit, që P/ligji t'i kthehet sponsoruesit- Qeverisë, me kërkesë që të rihartohet duke plotësuar standardet themelore të legjislacionit, dhe nevojat përmbajtësore e specifike të Republikës së Kosovës.

#### **e) Bordet e Agjencive të Pavarura**

**Kryetarja** - Kërkoi nga Komisioni t'i dërgohet një rekomandim Qeverisë, në të cilin do të kërkohet të kompletohen bordet e Agjencive të Pavarura dhe të funksionojnë sipas Ligjit.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë:

#### **Rekomandim**

- I. Qeveria e Republikës së Kosovës ta shqyrtojë situatën aktuale në bordet e agjencive të pavarura dhe të ndërmerren veprime ligjore për kompletimin dhe funksionalizimin e tyre në pajtim me ligjin përkatës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Kryetarja e Komisionit

---

Myzejene Selmani